



REPUBLIKA E KOSOVËS	REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS	VRHOVNI SUD KOŠOVA
G.J.A-Su.A	421 2023
Dt:	27. 02. 2023
PRISHTINË - PRIŠTINA	

**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO**

---

Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 27 shkurt 2023, me vota unanime nxjerr këtë:

**MENDIM JURIDIK**

**Lidhur me ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publikë: drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe kompetencën lëndore të gjykatave**

- I. Në kontestet nga marrëdhëniet e punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publik: drejtorët, zëvendësdrejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme që kanë lindur pas datës 09 korrik 2020, zbatohen dispozitat e Ligjit për Zyrtarë Publik, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, /Nr.8/11 mars 2019, Prishtinë), si dhe dispozitat e Ligjit të Punës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr.90, datë 01.12.2010).
- II. Drejtorët, zëvendësdrejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme, janë nëpunës të shërbimit publik, në kontestet e marrëdhënies së punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publikë, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, përvç nëse shprehimi shpërblimi ndryshe me ligj të veçantë, dhe gjykohen sipas rregullave të procedurës kontestimore.

**Arsyetimi i Mendimit Juridik**

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta ka konstatuar praktikë jo unike në kontestet e marrëdhënieve së punës, për kategorinë e të punësuarve në bazë të Ligjit për Zyrtarë Publikë, dhe atë: drejtoret, zëvendësdrejtoret si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme. Praktika jo unike e gjykatave të instancave më të ulëta, kryesisht ka të bëjë me ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publik: drejtoreve, zëvendësdrejtoreve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe kompetencën lëndore të gjykatave.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga praktika e saj, por edhe nga kërkesat e vazhdueshme që ka pranuar nga gjykatat dhe gjyqtarët e vlerëson me interes për standardizimin e praktikës gjyqësore, adresimin e çështjes lidhur me ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publikë: drejtoreve, zëvendësdrejtoreve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe kompetencën lëndore të gjykatave përmes një mendimi juridik.

Juridikioni i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë udhëzues juridik në rastet kur vërehet praktika jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sfidat në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për Gjykatat. Me nenin 27 të këtij ligji, përcaktohet se seanca e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës ka të drejtë të nxjerrë udhëzues juridik, qëndrime parimore dhe mendime juridike, me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore, ndërsa nevoja e adresimit të kësaj çështjeje përmes mendimit juridik, ka rrjedhë si propozim i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe konkludim i Gjykatës Supreme të Kosovës, pas shqyrimit, analizës dhe vlerësimit të një numri të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore për çështjen e theksuara si më lartë, e po ashtu edhe nga kërkesat, pyetjet apo sugjerimet e gjykatave të rregullta apo gjyqtarëve.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nxjerra e këtij mendimi juridik do t'i kontribuojë në radhë të parë unifikimit të praktikës gjyqësore, vendosjes së standardit të ligjshmërisë në vendimmarjen gjyqësore për çështjen që ka të bëjë me ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publikë: drejtoreve, zëvendësdrejtoreve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe kompetencën lëndore të gjykatave, efikasitetit, performancës së gjyqtarëve dhe besimit të publikut në gjykata. Kjo për shkak se përmes standardizimit të praktikës gjyqësore ndikohet në ligjshmërinë e vendimmarjes, efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në gjykata.

Objekt i këtij mendimi juridik janë pothuajse të gjitha situatat e kërkesave, për ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publik: drejtoreve, zëvendësdrejtoreve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe kompetencën lëndore të gjykatave.

Arsyetimi i këtij mendimi juridik ndjek kronologjinë e çështjeve të trajtuar sipas ndarjes në pikat.

**Arsyetimi për pikën I (një) të mendimit juridik** - është standard i së drejtës civile që ligji material do të vlej në kohë të caktuar dhe territor të caktuar. Në këtë kontekst përcaktohet edhe zbatimi i dispozitave të ligjit për Zyrtarë Publikë dhe dispozitave të Ligjit të Punës, duke marrë si

bazë kohën e lindjes së kontesteve nga marrëdhëniet e punës për kategoritë e nëpunësve të shërbimit publik: drejtorët, zëvendësdrejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, dhe në disa raste është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e ligjit i cili nuk ka mundur të zbatohet në kohën pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publikë, në kontestet nga marrëdhënia e punës, lidhur me ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publikë: drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe kompetencën lëndore të gjykatave. Siç duket këto situata në disa raste kanë krijuar dilemën se cili ligj duhet të zbatohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjeve nga praktika e saj, por edhe sipas parimit për zbatimin e ligjit material përmes këtij mendimi juridik në pikën I, të këtij mendimi thekson se për të gjitha kontestet nga marrëdhëniet e punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publikë: drejtorët, zëvendësdrejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme (të cilat janë trajtuar me këtë mendim juridik) që janë lindur pas datës 09 korrik 2020, zbatohen dispozitat e Ligjit për Zyrtarë Publik, (Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës, /Nr.8/11 mars 2019, Prishtinë), si dhe dispozitat e Ligjit të Punës, (Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr.90, datë 01.12.2010).

**Arsyetimi për pikën II (Dy) të këtij mendimi juridik** - është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I, të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika II (dy) i referohet kontesteve nga marrëdhënia e punës, lidhur me statusin e zyrtarëve publikë: drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe kompetencën lëndore të gjykatave, të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publikë.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, statusi juridik i nëpunësve të shërbimit publik, si: drejtorët, zëvendësdrejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme, se a duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, dhe se kontestet e paraqitura në gjykatë a duhet të trajtohen në Departamentin e Përgjithshëm - Divisionin Civil, sipas rregullave të procedurës kontestimore apo në Departamentin për Çështje Administrative, sipas rregullave të konfliktit administrativ dhe në disa raste janë zbatuara në mënyrë të gabuar dispozitat e Ligjit të për Zyrtarë Publik.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, e mbështetë konceptin se në kontestet nga marrëdhënia e punës: drejtorët, zëvendësdrejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme, janë nëpunës të shërbimit publik, për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publikë, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë, dhe gjykohen sipas rregullave të procedurës kontestimore, për arsyen:

Me nenin 2 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtar Publik Ligji nr.06/L – 114, përcaktohet se: “Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë”, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës ” dhe në paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet se: “ Nëpunës i

Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”.

Me nenin 24 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: “ Zyrtari publik ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedure dhe çdo vendimmarje, që ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës”. Me paragafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “ Zyrtari publik ka të drejtë të qasjes në dosjen e tij personale dhe të kërkojë ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave të saj”, ndërsa në paragafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative” dhe në paragafin 4 të këtij neni përcaktohet se: “Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”.

Me nenin 64 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Përveç sa parashikohet shprehimi shërbimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës ”.

Me nenin 74 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: “Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhëni e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit ”. Në paragafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit”. Në paragafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “Shqyrimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave. Komisioni i Ankesave krijohet: 3.1. në çdo administratë të institucionit të shërbimit publik; 3.2. në çdo ministri për administratën e njësisë të Shërbimit Publik në kompetencë të administratës shtetërore; dhe 3.3. në çdo komunë për nëpunësit e administratës së njësisë së shërbimit publik në kompetencë të komunës”. Në paragafin 4 të këtij neni përcaktohet se: “Anesa shqyrtohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e saj”, ndërsa në paragafin 5 të këtij neni përcaktohet se: “Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente” dhe në paragafin 6 të këtij neni përcaktohet se: “Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për krijimin dhe procedurën e punës të Komisionit të Ankesave”.

Me nenin 35 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Nr.04/L-032, përcaktohet se: “Drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve arsimore, mësimdhënësit, asistentët dhe instruktorët zgjidhen përmes një konkursi publik në bazë të meritës personale, pa asnjë lloj

diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të têrthortë për arsyen reale apo të supozuara që ka lidhje me gjininë, racën, gjendjen martesore, orientimin seksual, përkatësinë etnike, nevojat e veçanta, pasurinë, vendin e lindjes, pikëpamjet politike ose filozofike apo rrëthanat e tjera ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore rezulton qartë se: drejtorët, zëvendësdrejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme, janë nëpunës të shërbimit publik, në kontestet e marrëdhënieve së punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publikë, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë, dhe gjykohen sipas rregullave të procedurës kontestimore, për arsyen se këto kategori të nëpunësve të shërbimit publikë nuk e kanë statusin e nëpunësve civil por të njëjtët në bazë të Ligjit për Zyrtar Publik, emërtohen me status të ri juridik “Nëpunës i Shërbimit Publik”, dhe se marrëdhënia e punësimit për këto kategori rregullohet me Ligjin për Zyrtar Publik, për çështje tjera ky ligj i referon në Ligjin e Punës dhe se për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga marrëdhënia e punës për këto kategori në kompetencë për të vendosur janë Gjykatat - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, dhe gjykohen sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe se në raport me këto kategori të punësuarve në shërbimin publik nuk mund të iniciohet konflikt administrativ siç është përcaktuar me nenin 15 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin përcaktohet se: “Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ”, dhe nenin 74 paragrafi 5 të Ligjit për Zyrtar Publik, siç është cituar më lartë.

Për të ardhur në një përfundim të tillë kjo gjykatë mori përbazë faktin se nëse i referohemi nenit 64 dhe 74, dhe të tjerave të Pjesës, V, të Ligjit për Zyrtar Publik, rezulton se regjimi juridik i nëpunësve të shërbimit publik lidhur me marrëdhëni e punësimit, rregullohet me Ligjin e Punës, përveç nëse parashikohet ndryshe me Ligjin për Zyrtar Publik, apo një ligj të veçantë i cili mund të parashikoj rregulla ndryshe me këtë ligj, por vetëm në përputhje me parimet nga nenin 6 dhe 7 i këtij ligji. Gjithashtu sipas nenit 74 të këtij ligji, përcaktohet mbrojtja juridike e të drejtave të cenuara nga marrëdhënia e punës, dhe procedura e ankimimit, në organin e punësimit, pastaj inicimi i procedurës gjyqësore, nëse nëpunësi i shërbimit publik nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit, në afatin vijues prej 15 ditë mund të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nenet 64 dhe 74 të pjesës V, e prevalojnë nenin 24 të këtij ligji, përfaktin se sipas këtyre dispozitave dhe pjesës V, të këtij ligji, rregullohet në mënyrë të veçantë regjimi juridik i nëpunësve të shërbimit publikë.

Përveç të cekurave për të ardhur në një përfundim të tillë, kjo gjykatë iu ka referuar edhe Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo - Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, mirëpo të njëjtat nuk e kanë përcaktuar se në rast kontesti palët ku mund të paraqesin padi, përfaktin se sipas këtyre dispozitave dhe pjesës V, të këtij ligji, rregullohet në mënyrë të veçantë regjimi juridik i nëpunësve të shërbimit publikë.

Andaj sipas këtyre dispozitave ligjore, rezulton se kategoria e “nëpunësve të shërbimit publik”, si në nenin 2, paragrafi 2, pika 2 dhe paragrafi 4, të Ligjit për Zyrtarë Publikë, si personel i nivelit të lartë, drejtues i lartë në të cilën bien edhe drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe sekretarët e shkollave

fillore dhe të mesme, nuk e ka kanë statusin e nëpunësve civil, dhe marrëdhënia e punës për këtë kategori rregullohet sipas Ligjit të Punës, Ligjit për Zyrtar Publik, apo ligj të veçantë, prandaj për zgjidhjen e kontesteve të punës të iniciuara në procedurë gjyqësore nga palët për këtë kategori, kompetente për të vendosur janë Gjykatat - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil.

*(Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur me datë 27 shkurt 2023)*